

SHENIME SHPJEGUESE


Pasqyrat financiare per aktivitetin e vitit 2020 te shoqerise Abissnet SHA jane plotesuar sipas kerkesave te ligjit nr 25/2018 dt 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare ", me ndryshimet perkatese ,Standarteve Kombetare te Kontabilitetit dhe ligjit nr 8438 dt 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat " me ndryshimet.

Aktivi i Pasqyres "Pozicioni Financiar"

1. Ne rubriken "Te drejta te tjera te arketueshme" per shumen 25,319,205 leke jane paraqitur kerkesat debitore ndaj shoqerive qe kane qene te grupit, kerkesa keto qe kane te bejne vetem me transaksione financiare dhe jo me transaksione tregtare midis tyre, pasi rastet e detyrimeve te ndersjellta qe kane rrjedhur nga transaksionet tregtare te shitblerjes jane te paraqitura ne llogarite klient ose furnitor te bilancit sipas rastit, gjendja e te cilave eshte paraqitur ne menyre analitike ne pasyrat perkatese qe shoqerojne bilancin. Ne vleren e mesiperme perfshihet dhe diferenca per vleren neto te paradhenieve te akorduara duke i zbritur fondet e garancise ndaj punonjesve te shoqerise.
2. Ne rubriken "Shpenzime te shtyra" per shumen 2,984,068 leke jane paraqitur shpenzime te cilat do te maturohen dhe njihen ne periudhat kontabel pas dates 31.12.2020 ne zbatim te kerkesave te SKK 1 "Kudri i pergjithshem per pergatitjen e PF", pika 41. "Konstatimi i drejtave/detyrimeve dhe perputhshmeria". Keto shpenzime do te njihen si aktiv i shoqerise ne dt 31.12.2020.
3. Aktivet afatgjat materiale dhe jomateriale jane paraqitur per vleren neto, pra vlera bruto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Pasivi i Pasqyres "Pozicioni Financiar"

4. Zeri "Titujt e huamarrjes" nen rubriken "Detyrime afatshkurtra" per shumen 51,159,509 leke, perfaqson nje linje kredie (overdraft) te marr tek Tirana Bank qe ne date 31.12.2014 per vleren 30,289,561 leke, nje detyrim per linje kredie ne valuten euro te marre tek Banka Credins e konvertuar ne ALL (12,369,948 Leke) dhe nje detyrim ndaj Bankes Credins per linje kredie ne vleren 8,500,000 leke.
5. Zeri "Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetesore" nen rubriken "Detyrime afatshkurtra" per shumen 8,028,620 Leke tregon shumen e pagave te muajit dhjetor te papaguar deri ne 31.12.2020 ne shumen 6,143,600 leke, perfshire dhe detyrimin ndaj organeve tatimore per sigurimet shoqerore dhe shendetesore te muajit dhjetor per shumen 1,885,020 leke.
6. Zeri "Te pagueshme per detyrimet tatimore" perbehet nga detyrimet per TVSH tatim ne burim, te muajit dhjetor 2020 te paguara ne janar 2021, detyrimet per TAP te muajit dhjetor 2020 te paguara ne janar 2021 dhe detyrimi per tatim fitimit e vitit 2020 sipas ketij bilanci dhe deklarates se tatim fitimit qe eshte dorezuar brenda dates 31.03.2021.



7. Zeri "Titujt e huamarries" nen rubriken "Detyrime afatgjata" kap vleren 59,864,715 leke e cila perfaqeson saldot e dy kredive afatmesme prane Credins Bank, disbursuar gjate vitit 2017, te cilat sipas planeve te amortizimit respektive do te mbyllen brenda vitit 2022 dhe saldot e dy kredive te tjera afatmesme prane Credins Bank, disbursuar gjate vitit 2018, te cilat sipas planeve te amortizimit respektive do te mbyllen brenda vitit 2023.
8. Ne rubriken "Te tjera te pagueshme" jane paraqitur shumet e detyrimeve ndaj shoqerive te grupit dhe ndaj ish aksionerit per transaksione financiare si dhe detyrimet per qera financiare te marra per automjete te shoqerise inventari i te cilave shoqeron bilancin etj. Ne menyre analitike kjo rubrike kap vleren 67,479,501 leke.
9. Kapitali aksionar i shoqerise Abissnet SHA kap vleren 557,400,000 leke .
10. **Pasqyra e Performances (Te ardhura dhe shpenzime)**
11. Persa i takon shifres se qarkullimit total, ajo eshte e rakorduar me situaten tatimore ne dt. 31.12.2020 per shumen 470,554,272 leke. Librat e shitjes sikurse dhe librat e blerjes per te njejten shume, kane te reflektuar ne deklaratat mujore te Tvsh-se dhe vleren 321,433 leke pa Tvsh, e cila perfaqeson zerin "Autongarkese ne shitje" dhe "Autongarkese ne blerje" per sherbime te marra nga furnitore jo rezident ne RSH, ndaj te cileve eshte leshuar fature tatimore me Tvsh ne blerje dhe shitje, ne zbatim te ligjit nr 92/2014 "Per TVSH-ne" i ndryshuar, neni 86 "Personi pergjegjes per pagesen e Tvsh-se" pika 2. dhe neni 101 "Permbajtja e fatures" germa II). Sqarojme qe kjo shume nuk perfshihet ne vleren e qarkullimit total si me lart, persa nuk krijohet si rezultat i kryerjes se veprimtarise ekonomike.
12. Librat e shitjes sikurse dhe librat e blerjes per te njejten shume, kane te reflektuar ne deklaratat perkatese mujore te Tvsh-se dhe vleren 27,634,971 leke pa Tvsh, e cila perfaqeson zerin "Riklasifikim Inventari afatshkurter dhe kalim ne Aktive Afatgjate Materiale" per shumen 13,841,344 Leke dhe zerin "Riklasifikim Aktive Afatgjate Materiale dhe kalim ne Inventar afatshkurter objekt konsumi" per shumen 13,793,627 leke. Ne keto raste kemi te bejme me nje ndryshim perdorimi te aktiveve brenda objektit te veprimtarise se tatueshme te shoqerise Abissnet SHA per te cilat eshte leshuar fature tatimore me Tvsh ne blerje dhe shitje, ne zbatim te ligjit nr 92/2014 "Per TVSH-ne", i ndryshuar dhe ne perputhje me Udhezimin e Ministrit te Financave nr 6 date 30.01.2015 "Per TVSH-ne", i ndryshuar, neni 13, pika 8, paragrafi i fundit. Sqarojme qe keto shuma, nuk perfshihen ne vleren e qarkullimit total si me lart ne piken 11, persa nuk jane krijuar si rezultat i kryerjes se veprimtarise ekonomike te shoqerise.
13. Amortizimi i Aktiveve Afatgjata per vitin 2020 eshte llogaritur brenda normave te amortizimit te percaktuara ne ligjin nr 8438 dt 28.12.1998 " Per Tatimin mbi te ardhurat" me ndryshimet neni 22, sikurse pasqyrohet ne tabelen e amortizimit bashkangjitur.



14. Shpenzime te tjera ne shumen 171,542,912 leke jane kryesisht shpenzime per furnitura, pra per sherbime te kryera nga te trete si blerja e aksesit te internetit, te sherbimit te interkoneksionit, energji elektrike dhe utilitete te tjera, shpenzime postare e telefonike, publicitet reklama, shpenzime te telekomunikacionit, qira, prime te sigurimit te pasurise dhe automjeteve, tarifa, taksa automjetesh dhe taksa vendore, gjithashtu dhe shpenzime te tjera te panjohura per efekte fiskale.
15. Per vleresimin e debi kredive ne valut te huaj ne bilanc eshte perdorur kursi fiks i bankes se shqiperise per date 31.12.2020 dhe diferencat jane paraqitur ne fitim dhe humbje nga kursi i kembimit.
16. Ne llogaritjen e tatim fitimit eshte zbatuar norma standarte pra shkalla tatimore prej 15 %.
17. Ne menyre analitike shume rubrika te pasqyrave financiare jane dhene ne pasqyrat ndihmese qe e shoqerojne.

Drejtori i Finances
Fredi Dervishi

Fredi Dervishi
[Signature]

Administratori
Herjeta Deliaj

Herjeta Deliaj
